



Datë: 07.05.2026

A.nr. 255/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.255/2026, të datës 05.03.2026, të parashtruar nga ankuesi Sh.N, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, që të bëjë shqyrtimin e kërkesës Nr.107/2025 të datës 23.12.2025 të parashtruar nga ankuesi Sh.N, dhe të nxjerrë nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Sh.N (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 05.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar nën shenjë A.nr.255/2026 dhe numër protokoli:1169/2026, kundër heshtjes administrative të organit të punësimit/ Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 10.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik, ndërsa kjo e fundit më datë 18.03.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 17.04.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:2000/2026, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.255/2026 të datës 05.03.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 1169/2026 të datës 05.03.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e ankuesit e datës 23.12.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Akt Emërimit e ankuesit të datës 19.12.2023; Kërkesën e ankuesit të datës 12.02.2026; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 20.04.2026; Përgjigje në kërkesë e datës 18.03.2026; Akt emërimit e ankuesit të datës 12.03.2025.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesit, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 23.12.2025 të parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.04/2023 të datës 19.12.2023 dhe A.Nr.08/2025 të datës 12.03.2025 ka të themeluar marrëdhënien e punës në kuadër të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në pozitën “*Drejtore i Departamentit për Sisteme të Prokurimit Elektronik*”.

Ankuesi, me datë 23.12.2025 i është drejtuar Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik me kërkesën Nr.107/2025 për zbatimin e Vendimit Nr.08/280 të datës 19.12.2025 të Qeverisë së Kosovës, lidhur me zbatimin efektiv të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, me kërkesën që çështja e pagesave të bëhet në mënyrë retroaktive dhe atë me pagën e janarit 2026 ndërlidhur me vendimin Nr.23/165 të datës 12.10.2023 të Listës së Ekspertëve të kategorizuar sipas shtojcës 14.4 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa ankuesi me datë 12.02.2026 i është drejtuar institucionit me kërkesën për të kërkuar sqarime dhe njoftuar organin e punësimit se është në pritje të përgjigjes në kërkesën e tij të datës 23.12.2025, mirëpo nga shkresat e lëndës, respektivisht nga përgjigja e datës 17.03.2026 me shifër nr.26/2026 arrihet të konstatohet fakti se organi i punësimit, ankuesit nuk i ka kthyer përgjigje në kërkesën e tij të datës 23.12.2025.

Kundër heshtjes administrative të organit të punësimit, ankuesi me datë 05.03.2026 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se i njëjti është duke u dëmtuar financiarisht, ngase organi i punësimit është tu vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, me kërkesën që të aprovohet ankesa e tij, duke e detyruar organin e punësimit t'ia njoh të drejtën dhe t'ia bëjë kompensimin retroaktive të diferencës së pagës midis klasifikimit të vjetër B2 për të gjithë periudhën retroaktive si dhe duke e detyruar organin e punësimit që të bëjë ndryshimin në listën e pagave midis klasifikimit të vjetër dhe klasës B2 (ekspert).

Lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, meqenëse pala ankuese, me datë 23.12.2025 ka parashtruar kërkesë te organi i punësimit, atëherë Kolegji i Këshillit lidhur me obligimin e organit publik që të shqyrtoj kërkesën e palës dhe të nxjerr aktin administrativ, iu referua Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 11 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2, i cili përcakton se: *“3. Organi u siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth: 3.2. kërkesave thelbësore ligjore si dhe procedurave e formaliteteve të parashikuara për nxjerrjen e një akti administrativ apo realizimin e një akti real të kërkuar, përfshirë këtu edhe dokumentet dhe deklaratat që duhen parashtruar”*, nenit 27 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës”*, nenit 97 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative”*, në këtë rast, në kuptim të nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”*, dhe për rrjedhojë konstatoi, se organi të cilit i është drejtuar kërkesa, në rrethanat e rastit konkret Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është dashur të vendos brenda afatit prej 45 ditësh, apo të aplikohet neni 99 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mirëpo meqë kërkesa e palës ankuese nuk është shqyrtuar, atëherë është aplikuar instituti i heshtjes administrative.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi në rast se organi publik hesht ndaj kërkesës së palës, atëherë palës i lind e drejta që të parashtror ankesë te organi i shkallës më të lartë kundër heshtjes administrative duke u bazuar në dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”*, si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se meqenëse organi i punësimit ka heshtur ndaj kërkesës së ankuesit të datës 23.12.2025, ankesa e ankuesit e datës 05.03.2026 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në kuadrin ligjor të cekur si më lartë, lidhur me obligimin e organit përkatës për të vendosur lidhur me kërkesën e palës, e obligon Kryetarin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, që të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës Nr.107/2025 të datës 23.12.2025 të parashtruar nga ankuesi, në atë mënyrë që gjatë shqyrtimit të kërkesës të shqyrtohen të gjitha pretendimet e palës ankuese dhe të vendoset për të gjitha pretendimet në fjalë në kuptim të nenit 48 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë Juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda;A.nr.255/2026, datë 07/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Sh.N;
- Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (Kryetarit dhe Njësisë së Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.